



Datë: 08.08.2025
Numër Protokolli: 5373/2025

A.nr.1054/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare Ardita Haxhnikaj - Demi, dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1054/2025, të datës 03.06.2025, të parashtruar nga ankuesi K.H kundër organit të punësimit: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës numër A.nr.1054/2025, të datës 03.06.2025, e parashtruar nga ankuesi K.H.

A r s y e t i m

Ankuesi K.H, (në tekstin e mëtejme referuar: ankuese), me datë 03.06.2025, ka parashtruar ankesë, e regjistruar nën shenjën A.nr. 1054/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur konkursin me numër referencës RN00017154, për Grupin i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës, për pozitë, “Inspektor i Tokës Bujqësore”, Profesional 1, numri i kërkuar 5, pozita të zhvilluar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, ndërsa, kjo e fundit më datë 23.06.2025, ka përcjell përgjigje në ankesë së bashku me provat materiale referuar çështjes në procedurë ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit ka gjetur se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë më datë 21.03.2025 ka shpallur konkursin me numër reference RN00017154, për Grup i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës, pozita “ Inspektor i Tokës Bujqësore” klasa e pozitës Profesional I”, numri i kërkuar 5, ku afati për aplikim ka qenë nga data 22.03.2025 deri më 20.04.2025, ndërsa sipas shkresave të lëndës, në konkurs ka aplikuar dhe ankuesi.

Tutje, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, me datë 29.05.2025, me numër 3163, ka publikuar njoftimin lidhur me kandidatet fituese, nga i cili njoftim rezulton se kandidati L.M, është vlerësuar me gjithsejtë 98, pikë, kandidati N.N, është vlerësuar me gjithsejtë 98, pikë, kandidatja N.S, është vlerësuar me gjithsejtë 96.8, pikë, kandidatja E.S, është vlerësuar me gjithsejtë 93.6, pikë, dhe kandidati A.G, është vlerësuar me gjithsejtë 92.2, pikë.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit të parashtruara si në ankesë, thekson faktin se objekti i kësaj ankese është i njëjtë me objektin e ankesës për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr. A.nr. 1045/2025 të datës 07.08.2025, dhe për pasojë është anuluar Konkursi me numër reference RN00017154, për pozitën “Inspektor i Tokës Bujqësore”, të zhvilluar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

Andaj, duke qenë se me Vendimin A.nr.1045/2025, të datës 07.08.2025, është anuluar Konkursi me numër reference RN00017154, për pozitën “Inspektor i Tokës Bujqësore”, në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti i kësaj ankese është bërë i pamundur apo i kotë dhe për rrjedhojë konstaton se në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedurës administrative në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 104 ku përcaktohet se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”*.

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.1054/2025, të datës 03.06.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.1054/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Malsore Gashi- Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, K.H;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, dhe;
- Arkivit të KPMSHCK- së.